



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:247066

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05738153

KPPP.nr. 1866/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbaremore të kreditorit N.P.T “FERPLAST”, me numër unik identifikues 810641002 dhe seli në Ferizaj, rr. “Driton Islami”, p.nr., kundër debitorit “Ledi Ing” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811023473 dhe seli në Shtime, Carralevë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 813/23, i lejuar me datë 10.10.2023, nga Përmbareuesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Ledi Ing” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811023473 dhe seli në Shtime, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 813/23, i lejuar me datë 10.10.2023, nga Përmbareuesi Privat Destan Bujupaj.
- II. Urdhri Përmbaremore P.nr. 813/23, i lejuar me datë 10.10.2023, nga Përmbareuesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.T “FERPLAST”, mbi bazën e dokumenteve të besueshme – Faturës nr. 1551/23, e datës 05.07.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbaremore P.nr. 813/23, i lejuar me datë 10.10.2023, me të cilin është urdhëruar debitori “Ledi Ing” Sh.P.K., që në emër të borxhit të përcaktuar nga fatura, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 13,587.00, me kamatë ligjore prej 8 % sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se debitori ka nënshkruar kontratë me investitorin Haxha Com, ndërsa pasi që ka marr aprovimin nga këtu kreditori Ferplast për marrjen e sasisë së gypav, ky i fundit ka anuluar kërkesën për furnizim dhe ka shkëputur kontratën me debitorin, e si rezultat debitori ka përsuar dëm të dyfishtë krahasuar me borxhin të cilin debitori e ka ndaj kreditorit, për shkak se ka mbetur pa e kontraktuar punën në vlerë prej EUR 99,780.00 me personin e tretë, investitorin Haxha Com. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj në tërësi si të bazuar duke anuluar urdhrin përmbarimor.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se debitorin e ka njoftuar për detyrimin sipas faturës në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, ku i njëjti ka premtuar se ta ta përmbush detyrimin, mirëpo që nuk ka vepruar ashtu. Ka shtuar se pretendimet e debitorit në prapësim janë të pa bazuara dhe kanë si qëllim shtyerjen e përmbushjes së obligimeve si dhe nuk kanë lidhur ndonjë marrëveshje apo kontratë me debitorin, siç ka pretenduar i njëjti. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se përmbaruesi privat ka lejuar urdhrin përmbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 1551/23, e datës 05.07.2023, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për

arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar dhe nënshkruar nga debitori.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata mori parasysh pretendimet e debitorit lidhur me dëmin e shkaktuar si rezultat i pamundësisë së lidhjes së kontratës me investitor, mirëpo gjeti se të njëjtat pretendime nuk mund të jenë objekt shqyrtimit në këtë procedurë, për arsye se procedura përmbarimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat të LPP-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1866/23, datë 27.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.